



ALBANIAN UNIVERSITY

UNIVERSITAS-FABREFACTA-OPTIME

**DEPARTAMENTI I FARMACISË
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE
ALBANIAN UNIVERSITY**

UDHËZUES

HARTIMI I TEMËS SË DIPLOMËS



ALBANIAN UNIVERSITY

UNIVERSITAS-FABREFACTA-OPTIME

PËRMBAJTJA

1. HYRJE NË UDHËZUES.....	3
2. PROCEDURAT E MBROJTJES SË DIPLOMËS.....	3
3. MIRATIMI I TEMËS SË DIPLOMËS.....	4
4. METODOLOGJIA E PUNËS.....	5
5. TË SHKRUARIT DHE PUNIMI I DIPLOMËS.....	6
6. PARAQITJA, DORËZIMI DHE MBROJTJA E TEMËS SË DIPLOMËS.....	7
6.1 FLETËPARAQITJA	7
6.2 HYRJE.....	7
6.3 PËRMBAJTJA.....	8
6.4 PËRPUNIMI I TEMËS.....	8
6.5 DISKUTIMI I TEMËS.....	8
6.6 PËRFUNDIMI.....	9
6.7 SHTOJCAT.....	9
6.8 LITERATURA	9
7. VLERËSIMI I DIPLOMËS, ORIGINALITETI SHKENCOR I PUNIMIT	10



ALBANIAN UNIVERSITY

UNIVERSITAS-FABREFACTA-OPTIME

1. HYRJE

Në përfundim të kursit të plotë të studimeve të nivelit të dytë, pra me shlyerjen e plotë të detyrimeve, përfshirë edhe praktiken profesionale, bazuar në planin mësimor, studenti i sistemit pesëvjeçar, fiton diplomë në Programin e Studimit “Master i Shkencave në Farmaci”. Procesi i diplomimit realizohet me anë të provimit të diplomës, apo mbrojtje të temës së Diplomës.

2. PROCEDURAT E MBROJTJES SË DIPLOMËS

Sesionet e Diplomës

Tema e diplomës është e parashikuar në Planin e Studimeve në Farmaci, me 10 kredite. Studenti ka të drejtë të fillojë zhvillimin dhe hartimin e temës së diplomës duke nisur që në fillim të vitit të Pestë akademik të studimeve në Farmaci. Mbrojtja e temës së diplomës zhvillohet në sesionin e verës .

Komisioni i Diplomës

Studenti prezanton temën e tij të diplomës përpara një komisioni që quhet komisioni i Temës së Diplomës. Përbërja e komisionit propozohet nga departamenti dhe miratohet nga Dekani.

Procedura e Mbrojtjes së Diplomës

Studenti që mbron me sukses provimin e diplomës, apo temën e diplomës, pajiset me titullin “Master i Shkencave në Farmaci”. Procedura e mëtejshme për hartimin dhe dorëzimin e diplomës së Masterit të Shkencave mbështetet në Rregulloren e Përgjithshme të Albanian University, si dhe përgjatë këtij Udhëzimi.



ALBANIAN UNIVERSITY

UNIVERSITAS-FABREFACTA-OPTIME

3. MIRATIMI I TEMËS SË DIPLOMËS

Studenti në bazë të aftësive dhe interesit të tij , përcakton temën dhe titullin e diplomës në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor të tij.

Punimi i temës së diplomës është një punë profesionale në të cilën studentin punon nën drejtimin e një Udhëheqësi Shkencor. Tema e zgjedhur ka si qëllim të zgjerojë dituritë teorike e praktike të fituara gjatë studimeve; aftësimin e përdorimit të metodave shkencore në përpunimin dhe zhvillimin e temës; përdorimin e literaturës të vendit dhe të huaj, që do të ndihmojnë për shtjellimin e temës. Në fillim të vitit akademik, studentin duhet të paraqes një kërkesë me shkrim për miratimin¹ e Temës së Diplomës, të nënshkruar nga udhëheqësi i tij dhe nga Drejtuesi i Departamentit të Farmacisë.

Mbas miratimit të temës së diplomës, studentin përgjatë punimit dhe zhvillimit të temës, duhet të marrë pjesë në 3 (tre) konsultime me udhëheqësin e tij në prani të drejtuesit të departamentit të Farmacisë. Konsultimet janë të detyrueshme, dhe shërbejnë për mbarëvajtjen e punës dhe ecurinë e zhvillimit të temës nga ana e studentit. Konsultimet dokumentohen me anë të një deklaratë², e cila firmoset nga kandidati dhe udhëheqësi i tij.

4. METODOLOGJIA E PUNËS

Paraqitja e Temës së Diplomës

Pasi të ketë marrë miratimin nga Drejtuesi i Departamentit të Farmacisë, studentin fillon punën e tij individuale të pavarur teorike-praktike apo kërkimore-praktike nën drejtimin e Udhëheqësit të tij. Në paraqitjen e temës, studentin duhet të tregojë aftësitë e përfutuara; njohjen e literaturës profesionale të përdorur për studim dhe në mënyrë të rregullt e citon atë; njeh mirë fushën e studimit dhe terminologjinë profesionale të përdorur. Në paraqitjen e diplomës,

¹ Shkresa për miratimin e temës së diplomës gjendet bashkëngjitur

² Deklarata gjendet bashkëngjitur Udhëzimit



ALBANIAN UNIVERSITY

UNIVERSITAS-FABREFACTA-OPTIME

studenti duhet të shprehi aftësinë e të menduarit, analizuarit dhe dhënien e përfundimeve e propozimeve për zgjidhjen e problematikave të ndryshme të lindura përgjatë studimit të Temës. Tema e diplomës duhet të paraqitet me shkrim “ Times NeË Roman”, dhe duhet të ketë një përmbajtje nga 50-60 faqe.

Dorëzimi i Temës së Diplomës

Studenti mbasi përfundon së shkruari temën e diplomës dhe mbasi mer vlerësimin pozitiv të udhëheqesit të tij duhet ta dorëzojë atë 7 ditë përpara datës së diplomimit në 3 kopje për;

- Komisionin e Diplomimit.
- Departamentin të Farmacisë
- Arkivën së Fakultetit të Shkencave Mjekësore

Mbrojtja e Temës së Diplomës

Pas pranimit të punimit të diplomës, komisioni ka një afat prej 7 (shtatë ditësh) për të bërë vlerësimin e punimit me shkrim të diplomës, dhe nëse vlerësimi është pozitiv atëherë miratohet mbrojtja e saj që është publike dhe zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.

Procedurën e mbrojtjes së Diplomës e udhëheq Kryetari i Komisionit. Kandidati ka në dispozicion një kohë prej 15 minutash, në të cilën prezanton Temën e tij, përshkruan metodat e aplikuara dhe përfundimet; gjithashtu kandidati duhet të përshkruaj se ka zhvilluar një punë të pavarur dhe se zotëron literaturën e përdorur. Pas përfundimit të paraqitjes me gojë të temës, anëtarët e komisionit mund të parashtrajnë pyetje. Pasi kandidati t'u përgjigjet pyetjeve dhe pas diskutimeve eventuale, komisioni tërhiqet për të marrë vendimin e mbrojtjes së diplomës. Nota për vlerësimin e mbrojtjes së diplomës është e njëjta me notat në provime nga 5-10. Vlerësimi i temës dhe mbrojtja e saj nga kandidati bëhet me shumicën e votave të



ALBANIAN UNIVERSITY

UNIVERSITAS-FABREFACTA-OPTIME

komisionit. Mbi mbrojtjen e diplomës shkruhet një procesverbal i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit si dhe shënohet nota e diplomës.

Nëse tema e diplomës apo mbrojtja e temës së diplomës është vlerësuar me notë të pamjaftueshme nga ana e komisionit, *atëherë studenti humbet të drejtën e mbrojtjes dhe i nënshtrohet provimit me shkrim.*

5. TË SHKRUARIT DHE PUNIMI I DIPLOMËS

Hartimi i diplomës duhet të përmbajë këto të dhëna;

- Fletëparaqitja
- Hyrje
- Përmbajtja e materialit të studiuar
- Diskutimi i Temës
- Përfundimi
- Shtojcat
- Literatura

Punimi i diplomës lidhet detyrimisht me kapak të trashë dhe përmban ngjyrën dhe logon e Albanian University

6. PARAQITJA, DORËZIMI DHE MBROJTJA E TEMËS SË DIPLOMËS

6.1 Fletëparaqitja

Diploma fillon me Fletëparaqitjen³, e cila përman të dhënat kryesore si Universiteti, fakulteti, kursi i studimit, titulli i temës së diplomës, emri mbiemri i studentit si dhe emri i Udhëheqësit Shkencor.

³ Shembull i Fletëparaqitjes, aneks 1.



ALBANIAN UNIVERSITY

UNIVERSITAS-FABREFACTA-OPTIME

6.2 Hyrje

Hyrja përmban elementet bazë të tematikës që është marrë në studim.

Fjala “**HYRJE**” shkruhet me shkronja të mëdha dhe e shënohet me numrin 1. Për shembull:

1. HYRJE

1.1. Lënda dhe qëllimi i punimit

1.2. Burimet e të dhënave dhe metodat e kërkimit

1.3. Përmbajtja dhe struktura e punimit

6.3 Përmbajtje

Përmbajtja paraqet pasqyrën e faqeve të punimit. Në bazë të përmbajtjes janë caktuar kapitujt, titujt dhe nëntitujt. Për çdo kapitull caktohet titulli që përmban idenë kryesore. Strukturën përfundimtare të punës e jep vet studenti, kurse atë definitive, ai e bën në konsultim me Udhëheqësin Shkencor.

Parathënia

Punimi i diplomës mund të mos ketë parathënie. Megjithatë, nëse kandidati dëshiron, për të bërë një parathënie duhet të ketë parasysh për këto gjëra:

- Parathënien duhet ta dallojë nga hyrja. Në të ai duhet t'i përmendë kushtet që e kanë sjellë deri te paraqitja e punimit, përvojën gjatë të shkruarit, si dhe vështirësitë objektive të cilat janë paraqitur gjatë punës;
- Në hyrje mund të shkruhen edhe titujt akademikë dhe funksionet e njerëzve që autorit i kanë ndihmuar gjatë punës.

6.4 Përpunimi I Temës

Materialin e përvetësuar, studenti duhet ta përpunojë dhe ta strukturojë sipas kapitujve. Çdo kapitull titullohet më vete dhe fillon me faqe të re. Titulli i kapitullit shkruhet me shkronja të mëdha. Për të pasur një pasqyrë sa më të mirë, kapitujt mund të ndahen, ndërsa në të shkruar



ALBANIAN UNIVERSITY

UNIVERSITAS-FABREFACTA-OPTIME

fillojnë në faqe të re. Kapitujt, sipas nevojës, ndahen në nënkapitujt, ndërsa nënkapitujt në paragrafë.

6.5 Diskutimi Temës

Të dhënat e përfitura nga studimi i kryer krahasohen me të dhënat që paraqiten në literaturë dhe sipas rastit studenti jep mendimin e tij ndaj tyre .

6.6 Përfundimi

Teksti mbaron me përfundimin në të cilin shkurtimisht duhet të paraqitet rezultati që studenti ka arritur me studimin e kryer. Titulli “PËRFUNDIM” shkruhet me shkronja të mëdha në faqe të re.

6.7 Shtojcat

Detaje të hollësishme të të dhënave të cilat mund të rrisin dobinë e Temës së Diplomës për punë të mëvonshme por që janë shumë të detajuara për përfshirje në trupin kryesor të punimit të diplomës, mund të përfshihen si shtojca.

6.8 Literatura

Shfrytëzimi i literaturës vjen në faqen e fundit (pas përfundimit), pos nëse ka shtojca, kur vjen pas tyre. Titulli “**LITERATURA**” shkruhet me shkronja të mëdha dhe vendoset në qendër të faqes. Nëse janë përdorë më shumë burime, ato duhet t'i klasifikoni në: libra profesional, publikime shkencore, gazeta, revista shkencore apo artikuj shkencor. Artikujt e përdorur në punimet e diplomës shkruhen njësoj si librat. Së pari shkruhet autori i artikullit, e pastaj në thonjëza shkruhet artikulli. Pastaj më trashë (**bold**) shkruhet emri i revistës ku është botuar artikulli, vendi i botimit dhe viti, numri (nëse revista është në gjuhën shqipe, numri i revistës shënohet me **Nr.**, ndërsa nëse është në gjuhë të huaj, shënohet me **No**, që nënkupton Number) dhe viti i daljes së revistës, faqet ku gjendet artikulli (nëse bëhet fjalë



ALBANIAN UNIVERSITY

UNIVERSITAS-FABREFACTA-OPTIME

për revistë në gjuhën shqipe, viti i revistës shënohet me **Viti**, ndërsa nëse bëhet fjalë për tekst në gjuhë të huaj, shënohet me **Vol**, që nënkupton Volumen).

Për shembull

Arber Hoxha, “Mbi metodat e kerkimit shkencor në famaci”, **Detaje Farmakologjike**, Tiranë, viti VII, Nr.7, 2004, faqe 118.

7. VLERËSIMI I DIPLOMËS, ORIGJINALITETI SHKENCOR I PUNIMIT

Punimi i zgjedhur dhe metodat e përdorura për zhvillimin e temës së diplomës, duhet të jenë origjinale. Do të konsiderohet e dështuar dhe pa sukses çdo përpjekje për të kopjuar punime të Diplomave apo pjesë të tyre të trajtuara në vitet e mëparshme apo nga studentë të tjerë. Në rastet e mungesës së origjinalitetit, paralelisht me studentin kandidat, mban përgjegjësi edhe Udhëheqësi Shkencor.



ALBANIAN UNIVERSITY

UNIVERSITAS-FABREFACTA-OPTIME

Aneks 1

ALBANIAN UNIVERSITY
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORË
PROGRAMI I STUDIMIT MSC. FARMACI

TEMA

STUDENT

UDHËHEQËS

Tiranë

Datë, më